

Aplikacionet kërcënuese në rrjetet sociale

Rreziqe dhe këshilla







Rreziku nga rrjetet sociale që ju kanoset fëmijëve dhe adoleshentëve rritet çdo ditë, me përdorimin e aplikacioneve të ndryshme , që i lejon ata jo vetëm të komunikojnë por dhe të bullizojnë , kërcënojnë , apo fyejnë njeri tjetrin pa u identifikuar.Një nga këto aplikacione është edhe **"TELLONYM"**

CFARË ËSHTË SAKTËSISHT TELLONYM?

Krijuar në vitin 2016, nga tre studentë, Tellonym është një aplikacion anonim që inkurajon përdoruesit t'i bëjnë pyetje anonime përdoruesve të tjerë.



Cilat janë rreziqet?




Aplikacione të tilla kanë disa rreziqe potenciale duke përfshirë

- bullizmin
- abuzimin në internet
- sexting
- përmbajtje e papërshtatshme

Duke qenë se funksioni kryesor i aplikacionit është lidhja me të tjerët në mënyrë anonime, ndalimi i mesazheve të padëshiruara bëhet më i vështirë.

Këshilla udhëzuese për prindërit



- **Flisni me fëmijët dhe udhëzojini se nuk duhet të ndajnë gjëra private në internet, të tilla si:**

1. Informacione personale: si emri, emaili, numri i telefonit.
2. Të dhënat personale të njerëzve të tjerë
3. Linqe për t'u bashkuar në bisedat private në grup
4. Foto personale

- **Përdorni "parental control" për të bllokuar përmbajtje të dëmshme**

Parental control kufizon se cilat aplikacione të mediave sociale mund të përdorin fëmijët tuaj ose për sa kohë mund t'i përdorin ato.



- **Monitoroni sjelljen e fëmijëve tuaj**

Mënyra se si ata veprojnë kur përdorin mediat sociale mund të japë shenja të qarta se ata kanë nevojë për ndihmë

- **Vendosni një kufi moshe për fëmijët tuaj se kur duhet t'i përdorin rrjetet sociale**

Nuk ka dyshim se ne jetojmë në një botë digjitale dhe fëmijët bëhen gjithnjë e më të zgjuar në këtë epokë. Është e rëndësishme që të qëndroni vigjilentë gjatë prezencës së fëmijëve në botën e internetit.

